



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVO CUSTOMS  
 01.06.2020 DALJE - IZLAZ - PASSING  
 Nr. T.M.: 01/462/2020  
 Drejtoria e Doganës - Udhëheqës i Ekipit të Doganës

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers and Transfers



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 DEPARTAMENTI PËR KONTROLIN E AUDITIMIT  
 KANCELARIA REVIJE NATIONALE / NATIONAL AUDIT OFFICE  
 05 47 1576 7

Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs  
 Zyra e drejtorit të përgjithshëm

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

REFERENCE:	Nr i dokumentit: 611 08.05.2020					
PËR/ZA/TO:	Qerkin Morina - Ndihmës Auditor i Përgjithshëm					
CC:	Blerim Kabashi - Udhëheqës i Departamentit të Auditimit Jusuf Kryeziu - Udhëheqës i Ekipit të Auditimit					
PËRMES/PREKO/THROUGH:						
NGA/OD/FROM:	Ibrahim Xhaka - U.D. i Drejtort të Përgjithshëm					
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimt për Raportin Final të Auditimit të Pasqyrave/Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019					
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri,	Data:	01.06.2020		
Br. kancelarije:	Kucni:	Rr. Rexhep Krasniqi, 10000	Datum:			
Room No.:	Extension:	Prishtinë	Date:			
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action						
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/for approval						
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/for signature						
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/for comments						
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/may we discuss						
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/your attention						
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/as discussed						
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/as requested						X
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN						
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/for your information						X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE						

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (+381 38) 540 350 /540 836  
 www.dogana-ks.org

Të nderuar,

Ne kemi shqyrtuar dhe analizuar Raportin Final të prezantuar, e kemi vlerësuar atë dhe lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna ne kemi dhënë komentet përkatëse.

Dëshiroj po ashtu të ju falënderoj për punën profesionale që ekipi juaj ka bërë gjatë auditimit "Për Pasqyrat Financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019" si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kanë pasur me zyrtarët doganor gjatë periudhës audituese.


Duke e ditur peshën që ka raporti i auditimit për Institucionin e Doganës si dhe peshën që ky Institucion ka në shoqëri dhe për Buxhetin e Kosovës, ne si një Organizatë Buxhetore besojmë që konkluzionet dhe rekomandimet tuaja do të na ndihmojnë në arritjen e objektivave të parapara.

Ne kemi përgatitur Planin e Veprimit lidhu me adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport, si dhe masat që ne kemi ndërmarrë në lidhje me të gjeturat në Raportin Final.

Komentet tona dhe përkushtimi për Implementimin e Rekomandimeve (konkretisht përmirësimin eventual) janë domethënës dhe na ndihmojnë për përmirësimin e performancës së institucionit tonë në vazhdimësi.

Jeni të mirëseardhur në auditimet e radhës!

Me respekt,  
Ibrahim Xhaka  
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Nr	Të gjeturat /Çështjet	Rekomandimi	Veprimet që parashihen të ndërmerren me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve	Afati i zbatimit	Personat përgjegjës
1	Mangësi në kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimi i çmimeve uniforme, me rastin e rivlerësimit të mallrave për qëllime tatimore.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të mundësuar një proces korrekt të vlerësimit të deklarave doganore, përshkrimi tregtar dhe të ketë harmonizimin e dokumenteve me gjendjen faktike/faturën si dhe trajtim të barabartë të bizneseve.	Vlerësimi real i mallrave është një problematikë jo vetëm për R. e Kosovës por edhe për shtetet më të zhvilluara. Lidhur me vërejtjet për mos aplikim të çmimeve uniforme, do të ndërmerren masa në koordinim me Sektorët e Kontrollës Pos Dokumentare që të gjitha rastet e identifikuar për mos aplikim uniform të çmimeve të përmirësohen. Pra sektori i Kontrollës Pos Dokumentare dhe Kontrollës së Jashtme me rekomandim të Pranimit Qendror ndërhyjnë në deklarata pas importi dhe bëjnë përmirësimet e nevojshme në taksë.	Gjatë tërë vitit 2020 dhe në vazhdimësi.	DOK

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836

[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

2	Mos azhurnimi i kontratave të punës konform Udhëzimit Administrativ Nr. 36/2016.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kontratat e punës të zyrtarëve doganorë të azhurnohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Në fund të vitit 2019 është përgaditur drafti i kontratave të reja të punës në harmoni me legjislacionin e ri, gjegjësisht rreth këtij drafti kemi pranuar edhe komentet nga Zyra Ligjore, mirëpo ky draft nuk është finalizuar për arsye se, legjislacioni <sup>1</sup> konform të cilit është përgatitë ky draft i kontratave është pezulluar nga Gjykata Kushtetuese. Andaj, me rastin e pranimit të verdiktit final nga Gjykata rreth këtij legjislacioni, do të bëhet edhe azhurnimi i kontratave të punës të oficerëve doganor .	Në proces, varësisht nga përgjigja e gjykatës kushtetuese - por pavarësisht nga përgjigja e gjykatës, pas datës 30.06.2020 do të azhurnohen kontratat konform rekomandimit të ZKA dhe procesi do të përfundohet deri në fund të qerekut të tretë të këtij viti.	DSHP
---	--	---	--	---	------

<sup>1</sup> LIGJI NR. 06/L-111 PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK dhe LIGJI NR. 06/L - 114 PËR ZYRTARËT PUBLIK.

3	Numër i lartë i pozitive të paplotësuara.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj plotësimin e pozitive menaxhuese me rekrutime të rregullta, në mënyrë që menaxhimi të jetë më efikas dhe struktura organizative të kompletohet.	Lidhur me proceset avancuese – përgjatë vitit 2019 janë zhvilluar pesë (5) procese të avancimit të cilat janë shpallur sipas konkurseve si në vijim: konkursi i brendshëm për pozitën Oficer i Lartë Doganor me gradën OD2 me nr. protokolli 05.3.1/9956, dt. 31.07.2019; konkursi i brendshëm Udhëheqës departamenti me gradë OD5 me nr. protokolli 05.3.1/14198, dt.15.10.2019; konkursi i brendshëm Udhëheqës Sektori / Zyre Doganore me gradën OD4 me nr. protokolli 05.3.1/14200, dt. 15.10.2019; konkursi i brendshëm Udhëheqës i Sektorit të Përfaqësimeve me gradën OD4 me nr. protokolli 05.3.1/14199, dt. 15.10.2019 dhe konkursi i brendshëm Udhëheqës i Sektorit të Përkrahjes së DP-së me gradën OD4 me nr. protokolli 05.3.1/14197, dt.15.10.2019.	Procesi pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2020.	DSHP
---	---	--	--	---	------

Drejtoria e Doganës, Lagja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836

[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

			<p>Të gjitha këto konkurse janë hapur gjatë vitit 2019, ndërsa janë anuluar gjatë vitit 2020 bazuar në dispozitat e nenit 20 paragrafi 10 të Udhëzimit Administrativ Nr. 60/2019 për plotësimin dhe ndryshimin e UA Nr. 37/2016 për Rregullimin e marrëdhënies së punës së oficerëve doganor, sipas së cilës dispozitë ndër të tjera përcaktohet se "<i>i gjithë procesi i paraparë duhet të përfundoj brenda afatit 6 muaj</i>".</p> <p>Gjatë këtij vitit pritet të rishikohet struktura organizative dhe të përshtatet konform gradave eventuale si dhe të identifikohen nevojat reale për gradime.</p>		
4	Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, të monitorohet në mënyrë me efikase	<p>DP ka aprovuar një plan të detajuar në lidhje me hapat që do të ndërmerren për zbatimin e rekomandimit nga AP;</p> <p>-Ka formuar GP për plotësim ndryshimin e UA:</p>	Gjatë këtij viti por edhe viteve të ardhshme sepse është proces që duhet të jete	DAP

Drejtoria e Doganës, Lagja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836

[www.dogana-ks.org](http://www.dogana-ks.org)

		<p>procesi i menaxhimit të llogarive të arkëtueshme që mos të lejohet rritja e mëtejshme si dhe të ndërmerren veprime shtesë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve.</p>	<p>40/2017; -Ka caktuar. -Do të krijohet një GP për verifikimin e të gjitha borxheve.</p>	<p>ne vazhdimësi.</p>	
5	<p>Mos raportimi i obligimeve të papaguara.</p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të vendos kontrole të shtuara dhe të rrisë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar që obligimet që ato të raportohen me kohë, në mënyrë të plotë dhe brenda afateve të përcaktuara ligjore.</p>	<p>ZKF ka ndërmarr veprime konkrete që obligimet e papaguara të raportohen me kohë, në mënyrë të plotë dhe brenda afateve të përcaktuara ligjore. Janë obliguar zyrtarët e buxhetit që të informojnë ZKF për secilin raste kur ka rrezikshmëri për vonesë në realizimin me kohë të pagesave. Gjatë dy muajve të fundit të gjitha pagesat janë realizuar brenda afateve të përcaktuara ligjore.</p>	<p>Realizuar - Maj 2020</p>	<p>DSHP</p>